



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2019:292579

Datë: 21.06.2024

Numri i dokumentit: 05845606

PKR.nr.39/24

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PEJË, DEPARTAMENTI PËR KRIME TË RËNDA, në trupin gjykues të përbërë nga Kryetarja e trupit gjykues Nushe Kuka Mekaj, gjyqtarët profesionistë Arben Mustafaj dhe Blerta Kelmendi, me bashkëpunëtoren profesionale Elzana Kastrati, në çështjen penale kundër të akuzuarit A.T., për shkak të veprës penale të kryer në bashkëkryerje *Kontrabandim me migrant nga neni 170 par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së*, sipas Aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Mitrovicë, Departamenti për Krime të Rënda nën shenjën PP-I-nr.122/2017 të datës 13.12.2019, e përfaqësuar nga PTHDKR në Pejë, pas përfundimit të shqyrtimit gjyqësor, me datë 20.06.2024 bie dhe shpall publikisht, ndërsa me datë 21.06.2024, përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari **A.T.**, nga i ati dhe e ëma, gjinisë, i lindur me në fshatin, Komuna Rahovec, tani me vendbanim në fshatin, Komuna Rahovec, rr., i martuar, babai i 5 fëmijë, ka të kryer shkollën fillore, i gjendjes së dobët ekonomike, bujk, me numër personal lëshuar nga MPB të R. Kosovës, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

Për shkak se:

Në periudhë kohore nga data 25.08.2017 deri me datë 27.01.2018 në Mitrovicë, të pandehurit kanë vepruar në bashkëkryerje janë marrë me kontrabandimin e migrantëve e më qëllim të përfitimit të drejtpërdrejtë të dobisë financiare, duke ndërmjetësuar dhe ndihmuar në kalimin e paligjshëm të kufirit të shtetit pa përfill kushtet e domosdoshme për hyrjen e ligjshme në atë shtet të personave që nuk janë banor e as shtetas të atij shteti ku të njëjtit konkretisht kanë kontrabanduar viktimat me destinacion për kalim në vende të ndryshme të Evropës në atë mënyrë që të pandehurit kanë organizuar transportin e viktimave me veturat e tyre, duke i dërguar në

stacione të autobusëve dhe pastaj M.Th.dhe A.T. edhe me përcjelljen e viktimave deri në shtetet e Bashkimit Evropian, kryesisht përmes Bosnjes, Koracisë, Sllovenisë deri në Itali, ku çmimi për person është sjellë rreth 3000 Euro dhe viktimat kanë qenë kryesisht persona të mitur, duke filluar nga data 25.08.2017, kur të pandehurit kanë kontrabanduar njerëz-viktima jashtë Kosovës me destinacion në shtete të ndryshme të Evropës dhe zakonisht janë takuar në mes veti duke bërë plane, ashtu që L. i kontakton viktimat kurse M. kontakton me personat jashtë Kosovës, respektivisht në Bosnje, e po ashtu edhe axha i M. -A.T. ka udhëtuar me viktima jashtë shtetit dhe i njëjti ka njoftuar se është te kufiri i Serbisë dhe atë dy shqiptarë kanë zbrit, atëherë M. i thotë ai tjetri edhe me L. për çka besohet se të njëjtit kanë udhëtuar jashtë shtetit duke kaluar kufirin në këmbë apo nëpër ujë, sepse sipas deklaratës së B.B., familjar i L. dhe G.B.-viktima të kontrabandimit të njëjtit në mes të datave 19.11.2017 gjerë me datë 24.11.2017 ndalohen për hyrje ilegale nga autoritetet e rrugës dhe kanë kaluar nëpër ujë kufirin dhe janë malltretuar edhe në burgjet e Bosnjes dhe sipas Bujarit marrëveshja ka qenë me shku nëpërmes Kroacisë dhe jo Bosnjes dhe L. u kishte premtuar se kanë shkuar me vetura të mira “X5” dhe “Taureg” dhe për këtë ai i ka dërguar edhe 14 veta në këtë mënyrë. Po ashtu me datë 14.11.2017 nga policia sllovene ishte ndaluar i pandehuri A.T. i cili ka qenë në shoqërim me viktimat e kontrabandimit Blerim Isaj, K.Th. dhe B.M., të cilët kishin hyrë në territorin e Sllovenisë nga Kroacia ishte ndaluar në Slloveni me viktimat e kontrabandimit dhe të njëjtit pas ndalimit nga policia sllovene N.I., K.Th. dhe B.M., kanë kërkuar azil në Slloveni, kurse A.T. është depërtuar në Kroaci e pastaj i njëjti është kthyer për në Kosovë. Po ashtu i pandehuri A.T., se bashku me dy të Sh., P., M. dhe I.K. për në Evropë. Pastaj me datë 19.01.2018, i pandehuri A.T., realizon kontaktin me K.K., rajoni i Pejës me të cilën bisedon për ta dërguar për në Evropë, njeherit i pandehuri M.Th. për ta dërguar viktimën A. H., në Itali i ka kërkuar 2.700 Euro, për ta dërguar viktimën Q. bashkë i ka kërkuar 3000 Euro, në Itali ndërkaq i pandehuri L.V. për të transportuar L. B. në Itali, i ka kërkuar 3000 Euro, për të transportuar viktimën J.B. i ka kërkuar 3000 Euro, për të transportuar viktimën J.B. i ka kërkuar 3000 Euro, për ta transportuar viktimën për në Itali, G.B., i pandehuri L. i ka kërkuar 3000 Euro, për në Itali, ndërkaq A.T. për dërgimin e viktimave I.K., E.K., Sh.K., A.Z., për në Itali prej secili kishte kërkuar nga 2.900 Euro, në ndërkohë që veprimet për t'i kontrabanduar viktimat kanë ndër vepruar në mes veti. Po ashtu të i pandehuri L. V., me rastin e kontrollimit janë gjendur dokumentet e falsifikuara janë gjetur pasaporta me numër YA5085416, patentë shoferi i Italisë me numër serik R3961020, kartelë identiteti i Italisë me numër serik 2012385000AA, dëshmia 5 që ka të bëjë me lejen e qëndrimit i Zvicrës me numër serik A22111891, A22111920 e të cilat i njëjti i ka poseduar me qëllim që ti përdor në funksion të kryerjes së kontrabandimit.

-Me këta si bashkëkryerës ka kryer veprën penale *Kontrabandim me migrant nga neni 170 par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së.*

Andaj në aplikim të nenit 7, 17, 41, 42 par.1, pika 1.1, 43, par.1, pika 1.2 dhe 1.3, 45, 46, 73, 74, 75, 76, 83, 170 par.1 lidhur me neni 31 të KPRK-së, si dhe nenet 365, 364, 452 par.1 lidhur me nenin 449 par.1 dhe 2 pika 2.6 dhe 2.9, 462 të KPPRK-së, të akuzuarin e:

GJYKON

Me dënim me burgim në kohëzgjatje prej (1) viti, në të njëjtën kohë dënimi me burgim urdhërohet të mos ekzekutohet në afat prej një (1) viti, nëse i njëjti nuk kryen vepër tjetër penale, si dhe

DËNIM ME GJOBË në shumë prej 4000 Euro, duke i llogaritur kohën e kaluar në paraburgim dhe arrest shtëpiak nga data 21.03.2018 deri me datë 19.06.2018, dënim i cili do të ekzekutohet në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh, pasi plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Nëse i akuzuari nuk dëshiron ose nuk mund ta paguajë gjobën në tërësi, gjykata mund të zëvendësojë dënimin me gjobë me dënim me burgim, duke ia llogaritur një ditë burgim me 20 € gjobë.

Nëse i akuzuari nuk dëshiron ose nuk mund ta paguaj gjobën në tërësi, gjykata do ta zëvendësoj pjesën e mbetur të gjobës me dënim me burgim. Nëse personi i akuzuar e paguan pjesën e mbetur të gjobës, ekzekutimi i dënimit ndërpritet.

Obligohet i akuzuari që në emër të shpenzimeve të procedurës penale dhe paushallit gjyqësor, të paguaj shumën prej pesëdhjetë (50) €, në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Obligohet i akuzuari që në emër të programit për kompensimin e viktimave të krimit, të paguaj shumën prej pesëdhjetë (50) €, në afat prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Konform nenit 62 par.2, pika 2.6 të KPRK-së, i shqipton:

DËNIM PLOTËSUES

KONFIKSOHEN një telefon mobil G, me IME 1:358868089859456, IMEI 2:358869089859454 me sim kartelë “Vala”, me numër 8937701010-047721416.

Të dëmtuarit L. Berisha, G.B., A.H., G.B., Q.B. për realizmin e kërkesës pasurore juridike udhëzohen në kontest civil.

A r s y e t i m

Me datë 13.12.2019, Prokuroria Themelore në Mitrovicë, Departamenti për Krime të Rënda, ka ngrit Aktakuzë nën shenjën PP-I.nr.122/2017, ndaj të akuzuarve: Z.B. dhe Rr. K., për shkak të veprës penale *Kontrabandim me migrant nga neni 170 lidhur me nenin 31 të KPRK-së*, B.H., A.I. dhe F.Sh., për shkak të veprës penale *Kontrabandim me migrant nga neni 170 lidhur me par.6 lidhur me par.1 të KPRK-së*, M.Th., L.V. dhe A.T., për shkak të veprës penale *Kontrabandim me migrant nga neni 170 lidhur me par.6 lidhur me par.1 të KPRK-së*, A.I., për shkak të veprës penale *Mbajtja në pronësi, kontroll në posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPRK-së*.

Lënda në punë është pranuar me datë 27.02.2023, nga Gjykata Themelore Mitrovicë.

Me datë 11.12.2023, gjykata ndaj të akuzuarve M.Th. dhe L. V., ka veçuar procedurën, pasi që njëjtit gjenden jashtë vendit.

Ndërsa në raport me të pandehurin Z.B., gjykata me aktvendim të veçantë ka hedh pjesërisht aktakuzën dhe ka pushuar procedurën penale, meqë sipas njoftimit nga Agjencia e Regjistrimit Civil, i njëjti ka ndërruar jetë me datë 05.05.2023.

Proceduara penale ka vazhduar në raport me të akuzuarin Rr.K., B.H., F.Sh., A.I. dhe A.T..

Me datë 06.06.2024, gjykata ka veçuar procedurën penale ndaj të pandehurit A.T., për shkak se i njëjti nuk e ka pranuar fajësinë dhe gjykata ka vazhduar procedurën në raport me të Rr.K., B.H., F.Sh., A.I., të cilët i ka shpall fajtor dhe i ka dënuar sipas Aktgjykimit nën shenjën PKR.nr.32/23 të datës 13.06.2024, pasi që të njëjtit e kanë pranuar fajësinë për veprat penale sipas aktakuzës së përmirësuar.

Gjykata duke vepruar sipas aktakuzës ka caktuar dhe mbajtur seancën e shqyrtimit gjyqësor me datë 20.06.2024, në të cilën seancë prokurorja e shtetit ka lexuar aktakuzën e përmirësuar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Pas leximit të aktakuzës së përmirësuar, gjykata është bindur se i akuzuari e ka kuptuar aktakuzën, të njëjtit i ka dhënë mundësinë që të deklarohet për pranimin ose mospranimin e fajësisë, duke e njoftuar për rëndësinë dhe pasojat e pranimin të fajësisë, konform nenit 242 par.2 pika 2.1-2.4 të KPPRK-së.

I akuzuari A.T., pas njoftimit me të drejtat e tij, është deklaruar fajtor për veprën penale e cila i vihet në barrë, i vetëdijshëm për pasojat e pranimin të fajësisë, pranimin e ka bërë në mënyrë vullnetare, pas konsultimit të mjaftueshëm me mbrojtësin e tij.

Pas marrjes së mendimit nga prokurorja e shtetit dhe deklarimit të mbrojtëses, gjykata ka aprovuar pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit A.T., e bindur se pranimi i fajësisë është bërë konform dispozitës së nenit 242 par.2 pika 2.1-2.4 të KPPRK-së, se pranimi i fajësisë ka mbështetje në faktet e çështjes dhe shkresave të lëndës.

Meqenëse i akuzuari T., e ka pranuar fajësinë, gjykata ka kaluar në fjalën përfundimtare.

Prokurorja e Shtetit Valbona Disha Haxhosaj, në fjalën përfundimtare i ka propozuar gjykatës që me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin, të merret parasysh si rrethanë posaçërisht lehtësuese pranimin e fajësisë nga të akuzuarit në fjalë, ndërsa si rrethanë rënduese dashjen e lartë e të akuzuarve për kryerjen e veprave penal, andaj dhe i ka propozuar gjykatës që të njëjtit t'i dënoj sipas ligjit dhe t'i obligojë në pagimin e shpenzimeve të procedurës penale.

Mbrojtësja e të akuzuarit A.T., av. Njomza Hoxha, në fjalë përfundimtare i ka propozuar gjykatës që me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin, të merret parasysh fakti se është hera e parë që bie ndesh me ligjin, të kaluarën e pastër kriminale, moshën e shtyrë dhe në referim të këtyre rrethanave të njëjtit t'i shqiptoj një dënim sa më të butë në aplikim të nenit 71 të KPRK-së.

I akuzuari A.T., e ka mbështetur në tërësi fjalën përfundimtare të mbrojtëses së tij, duke shtuar se ndihet i penduar për veprimet e ndërmarra dhe në rast se i shqiptohet një dënim me burgim, do t'i vështrohet situata në familje, pasi që është mbajtes i vetëm.

Nga gjendja e vërtetuar faktike e përshkruar në dispozitiv të këtij aktgjykimi, gjykata ka gjetur se në veprimet e të akuzuarit A.T., ekzistojnë të gjitha elementet qenësore objektive dhe subjektive të veprës penale *Kontrabandim me migrant nga neni 170 par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së*.

Me rastin e matjes dhe shqiptimit të dënimit, gjykata për të akuzuarin, mori parasysh rrethanat lehtësuese dhe rënduese që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit në pajtim me nenin 73 të KPRK-së, ku si rrethanë lehtësuese mori sjelljen e tij gjatë gjyqimit, kohën e kaluar nga kryerja

e veprave penale, moshën e tij, ndërsa si rrethanë veçanërisht lehtësuese, bazuar në dispozitat ligjore të parapara me nenin 74 par.3 pika 3.10 dhe 3.11 të KPRK-së, mori pranimin e fajësisë si dhe faktin se ka shprehur keqardhje të sinqertë për kryerjen e veprës penale, andaj gjykata gjeti se janë plotësuar kushtet e parapara me neni 75 par.1 nënpar.1.1 dhe 1.2 të KPRK-së, e cila dispozitë ligjore përcakton që në rastet kur ekzistojnë rrethana posaçërisht lehtësuese, të cilat tregojnë se edhe me rastin e zbutjes së dënimit, mund të arrihet qëllimi i dënimit, gjykata mund të zbus dënimin, siç ka vepruar në rastin konkret ku të akuzuarit i ka zbutë dënimin si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, marrë parasysh se për veprën penale për të cilën është akuzuar, parashihet dënim me burgim prej dy (2) deri në dhjetë (10) vjet dhe në aplikim të nenit 76 par.1, nënpar.1.4 të KPRK-së, dënimi mund të zbutet deri në 6 muaj, ashtu që të njëjtit i ka shqiptuar dënim me gjobë dhe dënim me burgim të kushtëzuar, pasi bazuar në dispozitën e nenit 51 të KPRK-së, dënimi me kusht mund t'i shqiptohet kryesit të veprës penale për të cilin me ligj është i paraparë dënim me burgim deri në pesë vjet dhe për kryerësin e veprës penale për të cilin është paraparë dënim deri në dhjetë vjet burgim, nëse zbatohen dispozitat e zbutjes së dënimit.

Ndërsa si rrethanë rënduese konform nenit 74 par.2 lidhur me par.1, pika 2.2 të KPRK-së, gjykata mori shkallën e lartë të dashjes për kryerjen e veprës penale, mirëpo në raport me rrethanat lehtësuese gjykata erdhi në përfundim se të njëjtat mbizotërojnë në raport me këtë rrethanë, andaj dhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata, ka ardhur në përfundim se dënimi i shqiptuar të akuzuarit është në përputhje me shkallën e përgjegjësisë penale dhe me intensitetin e rrezikimit të vlerave të mbrojtura të shoqërisë, gjithashtu është e bindur se vendimi mbi dënim do të shërbej për arritjen e qëllimit të dënimit në pengimin e të pandehurve në kryerjen e veprave penale në të ardhmen, por ai do të ndikojë edhe si preventivë e përgjithshme për personat tjerë, që të përmbahen nga kryerja e veprave penale në përputhje me nenin 38 të KPRK-së.

Vendimi me të cilin të dëmtuarit janë udhëzuar në kontest civil për realizmin e kërkesës pasurore juridike, është marr konform nenit 463 par.1 dhe 2 lidhur me nenin 62 par.2 pika 2.6 të KPRK-së.

Vendimi lidhur me konfiskimin, u morr konform nenit 62 par.2, pika 2.6 të KPRK-së.

Vendimi mbi shpenzimet e paushallit gjyqësor është marrë konform nenit 449 par.1 dhe par.2 nënpar.2.6, nenit 450 par.1 dhe nenit 452 të KPPRK-së, ndërsa për shpenzimet për programin për kompensimin e viktimave të krimit është marrë konform nenit 36 par.3 nënpar.3.2 të Ligjit Nr.08/L-109 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Sa i përket propozimit në aktakuzë për konfiskimin e sendeve, përkatësisht të dokumenteve të falsifikuara, gjykata nuk ka vendosur, pasi që të njëjtat kanë të bëjnë me të akuzuarin L. Vehapi, për të cilin është veçuar procedura, si dhe në raport me tani të ndjerin Zelqif Braka, për të cilin është pushuar procedura penale.

Vendimi me të cilin të akuzuarve u është llogaritur koha e kaluar në paraburgim dhe arrest shtëpiak, është bazuar në nenin 83 të KPRK-së.

Andaj konform nenit 364 të KPPRK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PEJË

Departamenti i Krimeve të Rënda

PKR.nr.39/24

Bashkëpunëtore profesionale

Elzana Kastrati

Kryetarja e trupit gjykues

Nushe Kuka Mekaj

KËSHILLA JURIDKE: Kundër këtij aktgjykimi

është e lejuar ankesa në afatin pre 30 ditësh, nga dita e marrjes,

Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmjet kësaj Gjykate.